

UDHËZIM
Nr.20, datë 29.7.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË SHTOJCËN 1 TË UDHËZIMIT NR.5, DATË 22.1.2008
“PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE AKADEMIKE TË NEVOJSHME PËR
HAPJEN, MBYLLJEN DHE RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË
DOKTORATËS, SI DHE TË ELEMENTEVE BAZË, SIPAS TË CILAVE
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DUHET TË PËRGATISIN RREGULLOREN
PËRKATËSE

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e shtojcës 1 të udhëzimit nr.5, datë 22.1.2008 “Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse”, ndryshon si më poshtë:

“3. Elemente të përgjithshme të programit të studimit të doktoratës

Viti I
Viti II
Viti III

Kur, për raste të veçanta, kohëzgjatja normale e programit të doktoratës, në formën me kohë të plotë, nevojitet të jetë më shumë se tre vjet, të specifikohen elementet e përgjithshme të programit të studimit dhe për vitet e tjera.”.

2. Pika 4 e shtojcës 1, ndryshon si më poshtë:

“4. Plani i detajuar mësimor për thellimin teorik

Të jepet plani mësimor duke detajuar shpërndarjen në vite dhe semestra të disiplinave, të seminareve dhe çdo aktiviteti tjetër formues, shoqëruar me numrin e krediteve dhe orëve përkatëse, si dhe kërkesat për frekuentimin dhe verifikim të dijeve.

Emërtimi i aktivitetit	Kreditë	Orë mësimore	Viti/semestri	Frekuentim	Mënyra e verifikimit të dijeve	Personi përgjegjës
1.						
2.						
3.						
4.						

5.						
----	--	--	--	--	--	--

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja